



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Ali Salihu nga fshati Burojë, 41000 Skenderaj, Republika e

E PADITUR: REPUBLIKA E SERBISË – Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës
nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMIE PADITUR

Propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit

Vlera e kontestit : 1023 700 €

1.) Paditësi është djalë i babait te ndjerë Haxhi Salihut i cili është vrarë nga njësitet paramilitare serbe me datën 13.10.1998 ne fshatin Terstenik Komuna e Gllogovcit, ne shtëpi te mikut Bajram Orllati, ne shtëpinë e te cilit ishte i strehuar me familje e cila numëronte 5 anëtar ne kohëzgjatje prej 3 muaj. Diten kritike, babaj e ndan nga familja, se pari e torturuan pastaj e vranë.

Fillimisht Haxhi Salihu për t'ju shmang forcave serbe është detyruar ta braktise shtëpinë, duke u strehuar ne shtëpinë e Osmanit ne fshatin Izbice ne kohëzgjatje prej 2 muaj, pas largimit te forcave serbe për momentin familja kthehet ne shtëpi te ve, qëndron 2 jave dhe prapë rrezikohet nga lëvizja e forcave serbe shkon ne fshatin Tushil dhe qëndron nene tenda najloni 10 dite, nga aty ,familja shkon ne fshatin Verbovc ne vendin e quajtur “Fusha e mollës” prapë qëndron 15 dit nene tenda najloni, nga aty familja shkon ne Mitrovice qëndron tek një bamirës i panjohur, kthehet ne shtëpi dhe prapë pas 10 dite e braktisin shtëpinë dhe shkojnë ne fshatin Tersetik tek miku i shtëpisë Bajram Orllati ku qendrojn 3 muaj deri ne ditën e kobshme kur me datën 13.10.1998 ndahet nga familja, torturohet nga ana e ushtrisë serbe dhe vritet, familja prapë kthehet ne shtëpi ne fshatin Burojë.

Ne pranverë te vitit 1999 me 23 mars, duke u munduar për t'ju shmangur forcave serbe shkuam ne fshatin Izbice ku ishin grumbulluar me qindra familje nga fshatra te ndryshme dhe pas 5 dite vërsulen forcat serbe mbi popullatën, e kryen masakra te papara, une ju shmanga me nenën dhe bashkëshorten, vëllezërit ;Aliu dhe Samiu nxihen nga paramilitaret serb, maltreohen brutalisht por nuk vriten dhe bashkërisht me popullatën detyrohen te futen ne kolone për ne Shqipëri, ne vendlindje kthehen pas 2 muajve por me

pasoja te renda shëndetësore. Me pasoja te renda shëndetësore dhe çrregullim psikik ka mbet posaçërisht edhe nena Sala Salihu pas vrasjes se bashkëshortit dhe nga dhembja për djemtë e torturuar.

Provë : - vërtetimi nga D.SH.M.S. 09 Nr. 580 te datës 19.01.2009 për vrasjen e babait

Haxh Salihu,

- deklarata për bashkësinë familjare nenë numrin rend. 03/1-206/035e dt.19.1/09
- dëshmitë mjekësore për gjendjen shëndetësore te Sami Salihut dhe Avni Salihut
- vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit nr.325-111 te datës 23.01.2009
- dëshmia mbi patundshmërinë UL-72015031-00175 ,dt.16.01/09

2). Viktima nga forcat ushtarake policore serbe të udhëhequra direkt prej qeverisë se Serbisë e cila ka kryer veprime gjenocidiale , krime kundër njerëzimit ka humbur babajn dhe i janë traumatizuar vëllezërit si ne kërkesë , i është shkatërruar pasuria , është detyruar ta braktis vendbanimin se bashku me fëmijët ne kohë zgjatje prej 9 muaj duke banuar nepër shtepi te shumta nëpër fshatra te ndryshme shpesh herë edhe nëpër male dhe prroje dhe se fundit dhunshëm janë fut ne kolonë për ne Shqipëri ku kanë qëndruar 2 muaj dit

Provë : - Dëgjimi i paditësit anëtarëve tjerë të familjes dhe provave te tjera te cilat paditësi do ti prezantoj ne seancat e shqyrtimit kryesor dhe ne rast nevoje te caktohet edhe eksperti përkatës.

3.) Të drejtën për kompensim paditësi e bazon në nenin 185 te LMD (G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78) në lidhje me nenin 180.1 te te njëjtit Ligj , me te cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë te personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura ka qen e obliguar te pengoj aktet e vrasjes , dhunës, terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes se pasurisë se paditëses .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (neni 1 Protokolli nr. 1 , neni 2 dhe protokolli nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Paditësi propozon qe kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor te çështjes , t'i shfrytëzoj informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bjen këtë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkes padija e paditësit Ali Salihu nga fshati Burojë, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Republika e Serbisë - Qeveria e R.S. si pasardhëse juridike e Qeverisë se me parshme qe ne emër te te njëjtës te kompensoj demin material dhe jo material paditësit Ali Salihut,nga f.sh.Burojë, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumen prej 600.000 €për babajn Haxhi Salihun te vrarë më datën13.10.1998
- shumen prej 27 000 €për dhembjen shpirtërore dhe te munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi ne qiell te hapur dhe shtëpi te huaja ne kohëzgjatje prej 4 muaj
- shumen prej 50 000 për shkak te pamundësuarit e krenimit te festave fetare ne shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes se kontaktit me farefis dhe te afërmit
- shumën prej 200 000 €për dëmtim rend te gjendjes shëndetësore te vëllezërive; Sami Salihut dhe Avni Salihut
- shumen prej 120 000 €për shtëpinë e djegur dhe te shkatërruar,

- shumën prej 6 000 € për ter teknikën e bardhe në sallon dhe mobilierin e 4 dhomave te gjumit
- shumën prej 15 200 € për stallën, hamarin me drithë, koshin me misër te djegura si dhe bagëtinë prej 3 krerë lopë, dy kuaj, pastaj bletë dhe shpezët e plaçkitura
- Shumën prej 5 500 €, për motokultivatorin e plaçkitur me te tera veglat-pjesët përcjellëse.
- shumën prej ----- € për pamundësimin e shfrytëzimit te tokës bujqësore për tri vite

te gjitha këto shuma me kamat ligjore qe nga dita e ngritjes se padisë e deri ne ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit , nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

Pala e paditur te paguaj shpenzimet procedurale te kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

1.) të bihet :

AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit te paditëses në ter çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysh gjendjen e vështir ekonomike te paditëses ne kuptim me nenin te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006 .

Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi

Ali Salihu



Shtojcë ;

1. Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës e dt.20.01.2009 nr.580-61
2. Vërtetimet e D.SH.M.S. nr.580 09 Nr. 580 te datës 19.01.2009 për vrasjen e Babajt Haxh Salihu,
3. dëshmitë mjekësore për gjendjen shëndetësore te Sami Salihut dhe Avni Salihut
4. Deklarata për bashkësinë familjare nenë numrin rendor 03/1-206/035 e datës 19 janar 2009
5. Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme, UL- 72015031-00175 ,dt.16.01/09
6. Vërtetimi I Drejtorisë së Urbanizmit, nr.325-111 te datës 23.01.2009
7. 4 kopje te padisë